



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.4. 2023

Nr: 400

Ora:

**VENDIM**

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 61, DATË 19.4.2023, TË KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE, PËR PASQYRIMIN E EMRIT TË KRYETARËVE TË PARTIVE UDHËHEQËSE TË KOALICIONEVE "BASHKË FITOJMË" DHE "ALEANCA LIBERALE E DJATHTË" NË FLETËN E VOTIMIT**

Sot më datë, 23.4.2023, pasi u njoha me vendimin nr. 61, datë 19.4.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

**V Ë R E J:**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me shumicë votash ka vendosur:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore të paraqitur nga "Partia Demokratike e Shqipërisë", sa i takon pasqyrimin të emrit të kryetarëve të partive udhëheqëse të koalicioneve "Bashkë Fitojmë" dhe "Aleanca Liberale e Djathtë", në fletën e votimit.
2. Rrëzimin e kërkesës së "Partisë Demokratike të Shqipërisë" për sa i përket pasqyrimin të shkronjave nistore të partive përbërëse të koalicioneve përbri emrit të koalicionit përkatës.
3. Rrëzimin e kërkesës së palës së interesuar, koalicionit "Bashkë Fitojmë", për vendosjen e emrit të deputetit z. Sali Berisha në fletën e votimit si drejtues i koalicionit "Bashkë Fitojmë".
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ Brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Data: 23.4.2023 Nr. 400  
Ora:



Për zbatimin e vendimit nr. 61, datë 19.4.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, për pasqyrimin e emrit të kryetarëve të partive udhëheqëse të koalicioneve "Bashkë fitojmë" dhe "Aleanca Liberale e Djathtë" në fletën e votimit.

## PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 61, datë 19.4.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

## V E N D O S:

1. Pasqyrimin e emrit të kryetarëve të partive udhëheqëse të koalicioneve “Bashkë fitojmë” dhe “Aleanca Liberale e Djathtë”, në fletën e votimit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. brenda 3 ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**